



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



## LICENCË PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE

**DHËNË :**

**"HEP Energjia" SH.P.K.**

**Numri i Regjistrimit: ZRRE/Li\_43/15**

**Prishtinë, 14 tetor 2016**



PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| KREU I : TERMAT E LICENCËS.....  | 3  |
| KREU II: KUSHTET E LICENCËS.....   | 4  |
| Neni 1: Përkufizimet.....  | 4  |
| Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetet e të Licencuarit .....   | 4  |
| Neni 3: Çmimi i Furnizimit dhe Ndalimi i ndër-subvencionimeve dhe mos-diskriminimi .....   | 5  |
| Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit  | 6  |
| Neni 5: Ndalimi i keqpërdorimit të pozitës dominuese   | 6  |
| Neni 6: Ndërrimi i Furnizuesit   | 6  |
| Neni 7: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji | 7  |
| Neni 8: Detyrimet e të Licencuarit .....   | 7  |
| Neni 9: Mbrojtja e Konsumatorëve.....  | 7  |
| Neni 10: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes .....  | 8  |
| Neni11: Rregullat e Tregut.....  | 9  |
| Neni 12: Shëndeti dhe Siguria.....   | 9  |
| Neni 13: Puna .....  | 9  |
| Neni 14: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit .....  | 9  |
| Neni 15: Obligimi i Shërbimit Publik .....   | 9  |
| Neni 16: Blerja e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë   | 9  |
| Neni 17: Furnizuesi i Burimit të Fundit .....  | 10 |
| Neni 18: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së.....   | 10 |
| Neni 19: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës.....   | 11 |
| Neni 20: Taksat.....   | 11 |
| Neni 21: Masat Administrative dhe Gjobat .....   | 11 |
| Neni 22: Zgjidhja e Kontesteve .....   | 11 |
| Neni 23: Dispozitat kalimtare.....   | 11 |



## KREU I: TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji (tani e tutje "ZRRE")**, në pajtim me autoritetin e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L - 084), Nenin 18 të Ligjit për Energjinë (Ligji nr. 05/L – 081), Nenin 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji nr. 05/L-085), Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, me këtë i lëshon **Licencë për Furnizim me Energji Elektrike** ndërmarrjes "**HEP Energjia**" SH.P.K. (tani e tutje "i Licencuari").
2. Territori që mbulon kjo Licencë është tërë territori i Republikës së Kosovës.
3. I Licencuari ka të drejtë që:
  - 3.1. të shes energjinë elektrike Konsumatorëve Fundor, në përputhje me këtë licencë;
  - 3.2. të blejë energjinë elektrike në tregjet me pakicë dhe shumicë të energjisë elektrike me tarifa të parregulluara në përputhje me nenin 33/5 të Ligjit për Energjinë Elektrike;
  - 3.3. të rishesë të licencuarve tjerë dhe ndërmarrjeve tjera, me çmime të negociuara, tepricën e kapaciteteve dhe energjisë elektrike ;
  - 3.4. të importojë dhe eksportojë kapacitete dhe energji elektrike në përputhje me rregullat e aplikueshme;
  - 3.5. të faturojë dhe të inkasojë të hyra nga konsumatorët e vet në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm;
4. Licenca vlen nga 14.10. 2016 dhe do të vazhdojë të jetë e vlefshme për një periudhë pesë (5) vjeçare, deri më 13.10.2021, me mundësi vazhdimi në përputhje me nenin 32/2.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Nënshkruar nga **Arsim Janova u.d. Kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji**, sipas Vendimit të **ZRRE-së** (për ndryshim të emrit nga nga "HEP-KS SH.P.K" në "HEP Energjia" SH.P.K.) **V\_1118\_2019**, të datës **28.02.2019**.

(në emër të Bordit të ZRRE-së):

Nënshkruar me datë: 28.02.2019





## KREU II: KUSHTET E PËRGJITHSHME TË LICENCËS

### Neni 1: Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Licencë do të kenë kuptimin si në vijim:

**“Vit Financiar”** periudha prej 1 janar deri me 31 dhjetor e të njëjtit vit kalendarik

**“Rregullat e Tregut”** rregulla të miratuara nga ZRRE që përcaktojnë funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe raportet në mes të Operatorit të Tregut dhe pjesëmarrësve në treg, si dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit

**“Përgjegjësi Balancimi”** ka kuptimin si në Rregullat e Tregut të aprovuara nga ZRRE;

**“Konsumator Fundor”** Ka kuptimin si është dhënë me Ligjin për Energjinë Elektrike

**“Legjislacioni”** Ligji për Energjinë (Ligji nr. 05/L - 081), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L-084), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji nr. 05/L-085), Ligji për Konkurrencën (Ligji nr. 2004/36) si dhe legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë

**“Konsumatorë me Shërbim Universal”** nënkupton çdo konsumatorë që gëzon të drejtën e furnizimit universal siq përcaktohet me Nenin 3 paragrafi 1/72 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

2. Termet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptim si termet e përdorura në legjislacionin në fuqi.

### Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetet e të Licencuarit

1. I Licencuari do të përgatisë pasqyrat financiare vjetore në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin të nxjerra nga ZRRE-ja, dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të pasqyrave financiare të audituar, brenda tre (3) muajve pas përfundimit të vitit financiar. Llogaritë e brendshme për aktivitetet e të Licencuarit duhet të jenë të ndara nga llogaritë e brendshme për aktivitetet e tjera, sikur këto aktivitete të kryheshin nga ndonjë ndërmarrje tjetër.
2. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE pasqyrat financiare vjetore të audituara nga auditori i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.



3. Në llogaritë e tij të brendshme, i Licencuari do të mbaj llogaritë e ndara të furnizimit me energji elektrike të Konsumatorëve me të drejtën e Shërbimit Universal.
- 4 Nëse kërkohet nga ZRRE-ja, kohë pas kohe, i Licencuari duhet të dërgojë të gjitha llogaritë në formën dhe datën e specifikuar nga ZRRE-ja. Kontabiliteti rregullativ duhet të mbahet në përputhje me udhëzimet e ZRRE-së lidhur me raportimin e pasqyrave rregullative dhe, ndër të tjera, mund të specifikojë:
  - 4.1. formën e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, asetëve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë aktivitet tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktiviteteve të konsoliduara të të Licencuarit dhe çdo aktivitet tjetër;
  - 4.2. natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë informata për lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve nga aktivitetet e specifikuara;
  - 4.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazën për alokimin e shpenzimeve).
- 5 Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk duhet, sa i përket gjendjeve llogaritë në lidhje me vitet financiare, të ndryshojë bazat e pagesave, ndarjen ose alokimin nga ato të aplikuar në vitet e mëhershme financiare, përveç nëse ZRRE-ja ka lëshuar më parë udhëzimin relevant ose aprovimin me shkrim lidhur me këtë.
6. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja, dhe me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 3: Çmimi i Furnizimit dhe Ndalimi i ndër-subvencionimeve**

1. Çmimet e energjisë elektrike që ju ngarkohen Konsumatorëve Fundor nga i Licencuari do të vendosen lirshëm.
2. Gjatë ushtrimit të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, i Licencuari duhet të sigurojë që çmimet e furnizimit të mos ngritën e as të mos zbriten si rezultat i pranimit ose dhënies së ndonjë ndër-subvencioni (të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) nga ose për ndonjë aktivitet tjetër të tillë të Licencuarit apo nga ose për ndonjë entitet vartës, korporatë ose ndonjë person ligjor apo fizik.
3. I Licencuari duhet të sigurojë po ashtu që çmimet e ngarkuara nga ai nuk do të përfshijnë asnjë ndër-subvencionim (të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) midis konsumatorëve me



Shërbim Universal dhe konsumatorëve fundor dhe as mes konsumatori individual ose kategorive të konsumatorëve, me përjashtim të nivelit të miratuar nga ZRRE-ja.

#### **Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit**

Në vendosjen e çmimeve të cilat iu ngarkohen konsumatorëve për energjinë elektrike të furnizuar, i Licencuari nuk do të ketë preferenca për asnjë konsumator apo kategori të konsumatorëve, nuk do të ushtrojë diskriminim kundër asnjë konsumatori apo kategorie të konsumatorëve, dhe nuk do të vendos kushte të padrejta të furnizimit dhe të vështira për tu përmbushur.

#### **Neni 5: Ndalimi i keqpërdorimit të pozitës dominuese**

1. Të Licencuarit i ndalohet keqpërdorimi i pozitës dominuese siç përcaktohet me nenin 23 të Ligjit për Energjinë dhe legjislacionit tjetër në fuqi lidhur me këtë.
2. Në rast se ekziston dyshim ndaj të Licencuarit për shpërdorim sipas paragrafit 1 të këtij Neni, ZRRE do njoftoj Komisionin Kosovar për Konkurrencë dhe mund të shqiptoj të Licencuarit masa administrative dhe gjoba të përcaktuara me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

#### **Neni 6: Ndërrimi i Furnizuesit**

1. I Licencuari do të ndërmerr të gjitha masat e trajnimit të personelit të tij lidhur me aplikimin e Rregullave dhe procedurave për ndërrim të furnizuesit dhe respektimin e të drejtave të konsumatorëve për ndërrim të furnizuesit.
2. I Licencuari do bashkëpunoj plotësisht me ndërmarrjet tjera të licencuara gjatë procesit të ndërrimit të furnizuesit, dhe i ndalohet të Licencuarit që të vonoj apo pengoj këtë proces pa ndonjë arsye.
3. Kur konsumatori fundor i cili nuk gëzon të drejtën e Shërbimit Universal, dhe i cili njëherë veç ka ndërruar furnizuesin dhe ka ndërprerë Kontratën e furnizimit me energji elektrike me të Licencuarin, dhe kërkon prapë të lidh kontratë furnizimi me te, I licencuari nuk duhet ta refuzoj atë pa ndonjë arsye.
4. Kur konsumatori fundor i cili gëzon të drejtën e Shërbimit Universal veç është shkyçur dhe ka ndërprerë Kontratën e furnizimit me të Licencuarin, por prapë kërkon që të lidhë kontratë furnizimi me të Licencuarin, i Licencuari nuk duhet ta refuzoj një kërkesë të tillë po duhet të veproj sa më shpejtë e mundur sikur me kërkesat tjera të Konsumatorëve me Shërbim Universal.



## **Neni 7: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji**

1. I Licencuari do të veprojë në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Rrjetit, Kodeve të Matjes dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
2. I Licencuari do ketë Përgjegjësi Balancimi dhe do ndërmerr të gjitha veprimet e arsyeshme për të parashikuar nevojat e tija në mënyrë të saktë dhe të siguroj në mënyrë të plotë dhe të shpejtë të gjitha informatat që kërkohen nga ndërmarrjet tjera të energjisë elektrike në përputhje me procedurat e aprovuara nga ZRRE.

## **Neni 8: Detyrimet e të Licencuarit**

1. ZRRE, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve si dhe tregut të energjisë, ka të drejtë që të Licencuarit ti vendosë obligimin e ofrimit të Garancionit Financiar, në baza të përkohshme apo të përhershme.
2. I Licencuari do të kryej aktivitetin e licencuar në Kosovë në mënyrë efektive, ekonomike dhe të koordinuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. I Licencuari do të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme që të zbatojë obligimet sipas legjislacionit në fuqi, dispozitat e kësaj licence dhe marrëveshjet e lidhura me palë duke përfshirë çdo marrëveshje të lidhur për blerjen e energjisë.

## **Neni 9: Mbrojtja e Konsumatorëve**

1. I Licencuari do të sigurojë trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues ndaj të gjithë konsumatorëve sa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tyre përkitazi me shërbimet e energjisë elektrike.
2. I Licencuari është përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve të vet, duke bërë adresimin e ankesave në lidhje me çdo veprim, mospërfillje ose shkelje të bërë nga vet furnizuesi apo operatori i sistemit, si dhe të ofroj zgjidhje të duhur për këto ankesa, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e energjisë.
3. I Licencuari duhet të sigurojë të paktën një zyrtar gjatë orarit të punës, që t'iu përgjigjet pyetjeve dhe kërkesave të konsumatorëve.
4. Zyrtarët e të Licencuarit, që janë përgjegjës për pranimin e thirrjeve telefonike dhe pranimin e konsumatorëve në zyrë, duhet të jenë të kualifikuar dhe të udhëzuar siç duhet, për mënyrën e trajtimit korrekt dhe me shpejtësi në çështjet e ankesave/kontesteve dhe kërkesave për shërbim, apo t'i udhëzojë në departamentin përkatës.



5. I Licencuari është i detyruar t'u përgjigjet të gjitha ankesave të konsumatorëve, në mënyrë efikase dhe të drejtë, në pajtim me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
6. I Licencuari do të informoj konsumatorët e tij për adresën postare, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën elektronike të shërbimit të informatave, që i ka themeluar me qëllim të pranimit të ankesave të tyre apo raportimit të ndonjë incidenti.
7. I Licencuari është i detyruar t'i informojë konsumatorët e tij së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para çdo ndryshimi në kontratat e tyre për furnizim dhe për ndryshimet në çmime, dhe gjithashtu ti informojë ata për të drejtën për tu tërhequr nga kontratat, nëse nuk i pranojnë kushtet e reja të furnizimit.
8. I Licencuari duhet të sigurojë disponueshmëri të lehtë në pako të ndryshme të shërbimeve të tij për konsumatorët fundor.
9. I Licencuari është i detyruar të sigurojë në faqen e tij të internetit kalkulatorin për kalkulimin e kostos së energjisë elektrike.
10. I Licencuari duhet t'ua dorëzojë konsumatorëve fundorë njoftimin për skadimin e kontratës për furnizim të paktën 60 ditë kalendarik para afatit të skadimit.
11. I Licencuari është i detyruar t'i informojë konsumatorët për procesin e ndryshimit të furnizuesit.

#### **Neni 10: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes**

1. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me të gjitha standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike të miratuara nga ZRRE-ja.
2. Kur ZRRE-ja kërkon, apo kur i Licencuari e konsideron të arsyeshme, i Licencuari do të shqyrtojë standardet ekzistuese të përgjithshme dhe minimale të përmbushjes brenda afatit të përcaktuar nga ZRRE-ja.
3. I Licencuari do të zbatojë standardet e aprovuara dhe do t'i propozojë ZRRE-së për aprovim procedurën e monitorimit të përmbushjes së standardeve të cilësisë të furnizimit dhe shërbimit. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.
4. I Licencuari do t'i sigurojë ZRRE-së jo më vonë se 31 mars të çdo viti kalendarik Raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet që duhet përmbushur. Ky raport do të përfshijë informata dhe analiza lidhur me përmbushjen e standardeve sipas këtij neni.
5. I Licencuari, më 31 mars të çdo viti kalendarik do të publikojë statistikën ashtu siç i kërkon ZRRE-ja, lidhur me përmbushjen ose mos-përmbushjen e standardeve të performancës, të përcaktuara sipas këtij Neni.





### **Neni 11: Rregullat e Tregut**

I Licencuari do të veprojë në përputhje me Rregullat e Tregut në fuqi.

### **Neni 12: Shëndeti dhe Siguria**

1. I Licencuari do t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të mbrojtur personat dhe pronën nga dëmtimet që mund t'u shkaktohen nga ana e të Licencuarit dhe gjatë kryerjes së aktivitetit të tij do të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
2. I Licencuari, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontroll (auditim) teknik dhe të sigurisë së tij në baza vjetore, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë do t'i dërgojë në ZRRE, sa herë që kjo kërkohet nga ZRRE-ja.

### **Neni 13: Puna**

Lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë, i Licencuari do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

### **Neni 14: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

1. Për çfarëdo ndryshimi që pritet në kontroll, i Licencuari do të njoftojë ZRRE-në, paraprakisht, së paku gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarik. Ndryshimi në kontroll nuk do të hyjë në fuqi deri sa të miratohet nga ZRRE-ja.
2. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për çfarëdo ndryshimi të strukturës organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet ZRRE-së jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

### **Neni 15: Obligimi i Shërbimit Publik**

I licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimit publik që mund t'i vendoset nga ZRRE-ja në përputhje me nenin 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Obligimet e tilla të vendosura, do të bëhen pjesë integrale e kësaj Licence.



### Neni 16: Blerja e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë

I licencuari do të kryej çdo obligim lidhur me marrjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE), që mund ti vendoset atij si rezultat i hartimit apo aprovimit të bërë nga ZRRE.

### Neni 17: Furnizuesi i Burimit të Fundit

I Licencuari do të kryejë çdo obligim të shërbimit publik që mund ti vendoset nga ZRRE-ja, duke përfshirë edhe obligimin si furnizues i burimit të fundit, në përputhje me Nenin 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Nenin 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

### Neni 18: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së

1. I Licencuari do t'i dorëzojë ZRRE-së informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet kohore që ZRRE-ja mund t'i konsiderojë të nevojshme.
2. Nëse i Licencuari, në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale, kërkon që ndonjë informatë të konsiderohet si konfidenciale, ai ka për obligim që të shënjojë informatën e tillë si konfidenciale dhe të arsyetojë kërkesën e tij te ZRRE-ja. ZRRE-ja do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
3. ZRRE-ja ka të drejtë të kërkojë nga i Licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
4. I Licencuari do të emërojë një person përmes të cilit do të ketë lidhje komunikimi me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut si dhe me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes. Adresa, numri i telefonit, numri i faksit apo adresa elektronike e personit të tillë do t'i dërgohet Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut si dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
5. I Licencuari, sa herë që kërkohet nga ZRRE, do të dorëzojë një kopje të secilës kontratë të nënshkruar në lidhje me blerjen apo furnizimin e energjisë elektrike.
6. I licencuari do të dorëzojë në ZRRE detajet mbi çdo ndryshim të informatave të dërguara me aplikacionin për këtë licencë.

Në këtë nen:

**“Informacioni”** – nënkupton çfarëdo material të çfarëdo forme dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.



### **Neni 19: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës**

1. ZRRE-ja mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë, dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. ZRRE-ja mund ta transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

### **Neni 20: Taksat**

I Licencuari do t'i paguajë ZRRE-së çdo taksë fillestare dhe vjetore të përcaktuar sipas Rregullës për Taksat, të nxjerrë nga ZRRE-ja.

### **Neni 21: Masat Administrative dhe Gjobat**

1. Në rast të shkeljes së dispozitave të legjislacioni në fuqi, përfshirë rregullat e nxjerra nga ZRRE-ja, ose nenet e kësaj Licence, ose udhëzimet e dhëna të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca t'i vendos të licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i caktohen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

### **Neni 22: Zgjidhja e Kontesteve**

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet sipas Rregullës për Zgjedhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerra nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës, si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së legjislacionit në fuqi, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 23: Dispozitat kalimtare**

1. Pas hyrjes në fuqi të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, e cila është në proces të plotësimit ndryshimit e si rezultat i aprovimit të Ligeve për Energjinë,



kjo Licencë detyrimisht do ti nënshtrohet plotësim/ndryshimit duke përfshi edhe kohëzgjatjen e saj.

2. Çështjet të cilat nuk janë të rregulluara me këtë licencë, do të rregullohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.
3. I Licencuari, përgjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj licence, duhet të sigurojë posedimin e të drejtave ligjore mbi asetet me të cilat operon në territorin e Republikës së Kosovës, të cilat janë siguruar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
4. Licenca nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.